

POLICY BRIEF

Nga përfaqësimi formal i grave drejt influencimit efektiv në politikat vendore

Rasti i Bashkisë Shkodër

Gentiana Ramadani

Kandidate Ph.D.
Universiteti i Vjenës

2017

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në kuadër të programit “Përdorimi efikas i hulumtimit dhe advokimit mundëson politika më të mira evropiane në nivel lokal në Shqipëri”, drejtuar pjesëmarrësve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike. Programi ka për qëllim të mbështesë aktivitetet kërkimore dhe advokuese të alumnëve të Shkollës (rreth 300 drejtues të rinj nga profile dhe eksperiencia të ndryshme profesionale) me synim përmirësimin e politikave në nivel vendor.

Punimet hulumtuese u fokusuan në këtë fushë për shkak të implikimeve të rëndësishme të reformës administrativo-territoriale në nivelin e demokracisë vendore si dhe zhvillimeve të vullshme në qeverisjen vendore, të cilat kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me shërbimet që afrohen dhe janë të prekshme nga çdo qytetar.

Alumnët e përfshirë në këtë program patën mundësi të ndiqnin në terren pranë njësive të reja vendore ecurinë dhe problematikën e hasur në zbatimin e reformës administrativo-territoriale. Duke përballur eksperiencën e tyre profesionale dhe vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve të përditshme të njësive të reja vendore, punimet e alumnëve tentojnë që të evidentojnë shembujt pozitivë në njësi të caktuara me qëllim replikimin në njësi të tjera, si dhe të ofrojnë rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave aktuale.

Këto punime kërkimore synohet të prezantohen në aktivitete publike apo advokuese me pjesëmarrjen e vendimmarrësve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm, të cilët vijnë nga rrjeti alumni i shkollës dhe jo vetëm. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve siguron gjithashtu një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja. Nga njëra anë, alumnët pjesëmarrës të këtyre aktiviteteve kanë mundësinë të sjellin rekomandimet e tyre për hartuesit e politikave të rëndësishme, por njëkohësisht, edhe vetë ata bëhen më aktivë dhe shërbejnë si përçues nga lart-poshtë të këtyre ideve tek shtresat e tjera të shoqërisë. Publikimi i mëtejshëm i hulumtimeve dhe ngjallja e interesit të publikut të gjerë do të ndihmojnë në krijimin e politikave dhe vendimmarrjen e orientuar nga konsultimi me publikun si dhe angazhimin e mëtejshëm të qytetarëve në këto procese politikëbërëse.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron opinionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe të Akademisë së Studimeve Politike. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përkasin tërësisht autorëve. Autorët falenderojnë mentoren znj. Gentiola Madhi për mbështetjen dhe sugjerimet e dhëna në hartimin e këtyre punimeve.

PËRMBLEDHJE

Pjesëmarrja qytetare në dëgjesat publike kërkon besim dhe angazhim të të dy palëve për një qeverisje lokale sa më të mirë, transparente dhe që plotëson të gjitha nevojat e qytetarit të vet. Besim se ky angazhim do të bëjë ndryshimin në komunitet dhe që përfshirja e qytetarëve në politikat lokale do të ndikojë sado pak jeten social-ekonomike të gjithësecilit prej tyre. Që të arrihet një pjesëmarrje e ‘fuqishme’ në proceset vendimmarrëse të pushtetit lokal, qytetarët duhet të kuptojnë dhe të ushtrojnë të drejtën e tyre fillimisht si pjesëmarrës e gjithaq përgjegjësini për një pjesëmarrje të barabartë edhe mes gjinive. Gratë janë ai grup ku prioritetet e politikave të pushtetit lokal përfshijnë çështje, të cilat kanë ndikim edhe në sferën familjare. Gratë artikulojnë interesa, ndërtojnë aleanca, transmetojnë shqetësimin e drejtpërdrejtë etj. Prandaj përfshirja e tyre duhet të jetë sa më konkrete deri në nivele vendimmarrëse.

Ky dokument i shkurtër politikash sqaron se si pjesëmarrja e grave dhe vajzave në dëgjesat publike të organizuara nga Bashkia e Shkodrës do të thotë shumë më tepër se thjesht vetëm ftesa për të marrë pjesë. Do të thotë zgjerim në forma të tjera domethënëse të veprimit mes vajzave e grave dhe pushtetit vendor, për të ‘ngushtuar’ hendekun që ekziston sot midis pjesëmarrjes ‘sociale’ dhe asaj ‘politike’. Bazuar në rezultatet e intervistave të realizuara në njësinë numër 2 në Shkodër dhe në njësinë administrative Velipojë, me një metodologji mikse sasiore dhe cilësore, ky punim sjell në vëmendjen e aktorëve kryesorë shqetësimin për humbjen e besimit nga ky grup i shoqërisë. Në të njëjtën kohë punimi sjell edhe rekomandimet përkatëse, duke nënvizuar rëndësinë e formave të reja të përfshirjes së grave dhe vajzave tashmë edhe në proceset hartuese të politikave lokale.

HYRJE

[Disa studime ndër vite në Shqipëri](#) tregojnë se gratë janë të (vetë)përjashtuara nga proceset e dëgjesave publike, apo edhe kur ka pjesëmarrje, ajo është e ulët. Ndërkohë, kjo situatë bën që edhe ndikimi në vendimmarrje të jetë në nivele të ulta (përfshirë këtu edhe në familje).

Një arsye më shumë pse kjo situatë është e pafavorshme për gruan theksohet edhe nga vete ato, [duke e argumentuar se nuk çojnë ‘bukën’ në shtëpi](#).

Qeverisja lokale në të gjithë Shqipërinë po kalon në një proces ndryshimesh dhe transformimesh. Kjo sidomos në tre vitet e fundit, ku miratimi i reformës administrativo-territoriale, ndoshta më e rëndësishmja në vend që prej viteve 1990, rikonceptoi edhe njëherë funksionin e pushteti vendor në marrëdhënie me qytetarët. Procesi i “rindërtimit të një qeverisje” ndërmerret në emër të efikasitetit dhe efektshtmërisë, të cilat janë të dominuara nga tregu i vlerave në shoqëri (Osborne dhe Gaebler, 1992). Pra, kalimi nga ‘qeveri lokale’ në ‘qeverisje lokale’ ka në përbërjen e saj të gjithë përpjekjen për të gjetur forma të reja të përfshirjes së qytetarëve në ‘bashkëqeverisje’.

Prandaj, dokumentët e politikave lokale na ofrojnë një imazh më të qartë se si shërbimet publike janë më afër qytetarëve dhe ku vetë institucioni angazhon komunitetin lokal në vendimmarrje mbi shërbimet që do duhet të ofrojë apo prioritetet e tyre si komunitet. Janë pikërisht këto praktika të qeverisjes lokale ato që i japin formë pjesëmarrjes qytetare. Si çdo koncept tjetër edhe ‘pjesëmarrja publike’ është një ide tërheqëse për të forcuar demokracinë lokale apo qendrore. Ai është një komponent thelbësor në qëndrueshmërinë politike, sociale, ekonomike e deri edhe kulturore. Sa më shumë demokraci aq më mirë. Fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në dëgjesat publike, që lidhen ngushtë me përditshmërinë e tyre dhe që rrjedhin nga politikat e pushtetit lokal, ka të bëjë me fuqizimin direkt të tyre në vendimmarrje nëpërmjet aktivitete publike. Kjo mund të çojë deri në institucionalizimin e formave të reja të angazhimit të tyre, ku zëri përkatës nuk transmetohet nëpërmjet kryefamiljarëve apo pleqve të fshatit, siç njihet si praktikë në Shqipëri.

Format e institucionalizuara, të cilat bota dhe kryesisht Europa i ka identifikuar si hapësira publike, kanë zanafillën në punën e Hanah Arendt (1958). Koncept dhe punë që frymëzuan dhe gjetën zhvillim të thellë edhe në idenë e filozofit gjerman Jürgen Habermas (1992). Hapësira publike e Habermas është ajo hapësirë

sirë e cila fton në veprim dhe diskutim qytetarët për çështje apo shqetësime të përbashkëta dhe që vlerësojnë propozimet për ndryshim në terma të një qeverisje të mirë prej të cilave arrijnë të shprehen edhe opinione publike. Ideja e hapësirës publike ka ndryshuar shumë që nga shekulli i 18-të, nga ku e fillon analizën Habermas, e deri më sot. Sigurisht, një prej shqetësimeve më të mëdha në rrethet akademike ka qënë diskutimi i lënies jashtë të çështjeve gjinore. Mirëpo Nansy Fraser (1990) rikthen në vëmendje një prej argumenteve më domethënës në konceptin e hapësirës publike, duke i dhënë grave atë që Habermas i kishte marrë. 'Një dhomë për vetë' - atë dhomë që Virginia Wolf e kërkonte me ngulm, ndonëse specifikisht për gratë dhe vajzat shkrimtare. Kësaj radhe, sipas Fraser, hapësira publike dhe debati publik nuk mund të ndodhë pa praninë e të gjithë shtresave dhe grupeve të shoqërisë, përfshi këtu edhe gratë të cilat nuk vijnë nga familje borgjeze apo nga një familje me emër në shoqëri.

KORNIZA STRATEGJIKE GJINORE NË QEVERISJEN LOKALE

Në një vëzhgim dhe analizë të dokumentëve strategjikë të pushtetit qendror dhe atij lokal kuptohet se Bashkia Shkodër i ka funksionale kornizën ligjore si dhe politikat e brendshme të funksionimit të pushtetit lokal në raport me shërbimet që ofron për gratë dhe vajzat . Ajo çfarë ndodh në praktikë, sipas vetë grave dhe vajzave, është shumë larg nga kjo kornizë.

Në takimet publike, barazia gjinore, tashmë përtej kontekstit të pjesëmarrjes, për t'u dëgjuar e konsideruar, është në nivele të pafavorshme për gruan. Edhe kur pushteti lokal apo qëndror ka organizuar dëgjesa publike për çështje të rëndësishme për qytetarin, media na ka shfaqur gjithaq pamje ku burrat janë kryefjala e pjesëmarrjes.

“Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe eliminimin e gjitha formave të dhunës me bazë gjinore” e rishikuar në vitin 2011, është ai dokument politik, i cili i kërkon pushtetit vendor ndër të tjera të fokusohet më tepër në ngritjen e kapaciteteve administrative për t'iu përgjigjur nevojave të grave dhe vajzave.

Përveç qëndrave sociale dhe rehabilitimit të grave dhe vajzave të dhunuara, Bashkia e Shkodrës nuk ofron një shërbim më të specializuar në drejtim të përmirësimit të gjendjes dhe situatës së përditshme social-kultore ekonomike të grave, e cila ndikon edhe në përmirësimin e kulturës si mentalitet për t'u përfshirë, angazhuar dhe marrë pjesë me ide e sugjerime në çështje publike.

Ndërkohë korniza ligjore për barazinë gjinore në qeverisjen lokale ka krijuar detyrime ligjore për bashkitë, të cilat fillojnë që nga ligji nr. 9970/2018 për *“Barazinë gjinore në shoqëri”*, i cili ndër të tjera i kërkon pushtetit vendor: 1) të punësojë nëpunësin civil për çështjet gjinore në bashki, i/e cili/a do të merret me të gjitha problematikat apo shqetësimet, të dhëna dhe analiza përsa i përket barazisë gjinore; dhe 2) të ndërmarrë masa për të rritur dhe fuqizuar pjesëmarrjen aktive të grave në pozicione vendimmarrëse me së paku 30%.


Në korrik të vitit 2009, Bashkia e Shkodrës ka vënë në zbatim pozicionin e nëpunësit civil për barazinë gjinore dhe vazhdon të jetë funksionale. Ndërkohë, Këshilli Bashkiak Shkodër ka në përbërjen e tij 51 anëtarë nga të cilët 21 janë gra.

Pikërisht, për të kuptuar më mirë nivelin e përfshirjes se gruas në konsultime/dëgjesa publike dhe statusin e tyre në këto debate publike, të cilat ndikojnë më pas në veprimtarinë e pushtetit lokal, është shumë e nevojshme të studiohet se sa realisht korniza e lartpërmendur ligjore dhe institucionale manifestohet edhe në praktikë. Prandaj pyetja kryesore që ngrihet në këtë dokument është:

Në çfarë mase mekanizmat ekzistues të qeverisjes lokale për pjesëmarrjen publike mundësojnë pjesëmarrjen kuptimplotë të grave (përfshirë këtu shtresat e varfëra dhe të margjinalizuara) në planifikimin e programeve zhvillimore?


Për t'iu përgjigjur pyetjes kryesore, nënpyetja më poshtë vjen në ndihmë:

- *Si dhe sa ndikojnë gratë e vajzat në politikat lokale nëpërmjet pjesëmarrjes dhe përfshirjes së tyre në proceset dëgjimore publike?*



Me një metodologji mikse cilësore dhe sasore janë intervistuar 100 gra dhe vajza. Intervistat e hapura janë realizuar me 50 gra dhe vajza në Shkodër dhe në njësinë administrative të Velipojës. Ndërkohë pyetsorëve u janë përgjigjur 50 gra dhe vajza të tjera. Të dhënat e paraqitura më poshtë, në përqindje, janë rezultate të 44 pyetsorëve të plotësuar nga gratë dhe vajzat, 6 prej të cilëve nuk plotësojnë standardin e hedhjes së të dhënave. Për përpunimin e të dhënave është përdorur programi SPSS. Pjesë nga 50 intervistat e hapura janë përfshirë në tekst si citime kryesore.

Mosha e të pyeturve kryesohet nga grupmosha 51-60 vjeç (40%), e ndjekur nga grupmosha 31-40 (35%) dhe ajo e 41-50 me 20%. Niveli i



arsimimit ka patur një grafikë interesante pasi 48% i përkasin arsimit të lartë dhe 51% atij të detyrueshëm. Ndërkohë 63% e tyre nuk punojnë në krahasim me 37% të cilat kanë një punë.

Gratë dhe vajzat e pyetura vijnë nga një sfond mik, por pjesa më e madhe e tyre janë shtëpiake, ku sipas grafikës dhe përgjigjet e dhëna sqarohet se me 'shtëpiake' dhe 'nuk kam punuar kurrë' gratë nënkuptojnë punët që bëjnë në shtëpi. Kjo kategori së bashku është në masën 47.7%. Punonjëse në biznese të vogla apo si punëtore/mirëmbajtëse shtëpie janë 18.2%, ato që punojnë në profesionin e tyre sipas arsimit përkatës 18.2%, dhe agrokulturë

ku përmendet më tepër puna si fermere shkon në total 15.9%. Përzgjedhja ka qënë rastësore me fokus në njësinë numër 2 në qytetin e Shkodrës dhe njësinë administrative Velipojë.

PËRTEJ NUMRAVE, ÇFARË NA FLET REALITETI?

Vështirësitë për t'i mbledhur njerëzit dhe për t'i bindur që ato të përfshihen në dëgjesat publike, jo vetëm si numër, por si mendime që respektohen dhe përkthehen në praktika zyrtare, janë tashmë të njohura edhe në vende të zhvilluara (Abers, 2003).

Këto vështirësi duket se 'ndihmohen' edhe nga vetë pushteti lokal i cili dëgjesën publike e ka legjitimuar deri në nivele të pjesëmarrjes fizike të individit. Në shoqërinë tonë demokratike, njerëzit janë akoma vetëm në rolin e pjesëmarrësit. Në këto kushte pyetje si, pse të rrezikojmë dhe të formojmë struktura paralele lokale apo pse të mos demokratizojmë ekzistueset, i kanë rrënjët tek situata financiare e pushtetit lokal. Format e reja dhe inovative kërkojnë edhe angazhim financiar. Ndoshta kjo është edhe arsyeja pse Bashkia Shkodër mjaftohet më shpalljen e njoftimeve për dëgjesat publike vetëm në faqet web zyrtare, e cila sipas kërtimeve të kryera në kuadër të këtij punimi, rezultojnë të jetë burimi më i ulët i informacionit, me 1%.

Në fakt dëgjesat publike, si forma më e zhvilluar e demokracisë dhe pjesëmarrja publike aktive e qytetarëve si 'përgjegjësi qytetarë', gjenerojnë ide që vijnë drejtpërdrejtë nga komuniteti. Ide që lidhen me taksat lokale e që një familje duhet të paguajë, kapitalin social në shoqëri si përmirësimin e shërbimeve e institucioneve publike si biblioteka, qendra rinore sociale, etj, janë përbërësit kyç në zgjidhjen e problemeve por edhe ndryshimeve, të cilat vijnë si pasojë e angazhimit (Yanow, 2003; Wiseman, 2006, Adam dhe Hess, 2007). Mirëpo gra dhe vajza që janë pjesë e grupeve të marginalizuara të shoqërisë dhe jetojnë në varfëri nuk kanë shanse ose kanë pak mundësi të influencojnë procese politike ekonomike dhe sociale dhe institucione, të cilat kontrollojnë dhe formësojnë ditët dhe jetën e tyre, duke bërë të mundur kështu që të mbahen në 'kur-

the' të varfërisë e si rrjedhojë edhe të pabarazive (Oxford, 2008:1).

Në raste specifike dhe në kontekstin në të cilin është realizuar edhe punimi, pjesëmarrja publike ndeshet edhe me vështirësi kulturore, sociale dhe ekonomike të komunitetit. Nga njëra anë është vetë komuniteti i cili me të drejtë pyet se ç'ndryshim do të sillte pjesëmarrja e tyre në dëgjuesat publike? Apo kur gratë nuk kanë asnjë mbështetje për kujdesin ndaj fëmijëve të tyre në kohën e këtij angazhimi. Edhe pse garantimi i pjesëmarrjes vjen nëpërmjet bindjes se rezultatet dhe mendimet e tyre do të influencojnë politikat lokale, të cilat gjithashtu ndikojnë direkt në jetën e tyre të përditshme duke përmirësuar shërbimet e kopshteve, shkollave, rrugëve, ambjenteve kulturore për fëmijë dhe të rinj etj., sërish gratë shprehen se asgjë nuk ndryshon nga mos/pjesëmarrja e tyre.

Vida, 45 vjeçe, e pyetur rreth pjesëmarrjes së saj në dëgjuesat publike që organizon Bashkia Shkodër, thekson se: "nuk kam asnjë besim. Kam provuar dy herë të flas dhe të kërkoj, nuk më kanë dëgjuar. Nga ky moment nuk kam marr më pjesë në të tilla organizime sepse ne nuk na konsiderojnë".

Ndërkohë Maria, 37 vjeçe, thotë: "Unë nuk i kam parë dhe as dëgjuar ndonjëherë dikë të më thotë të marr pjesë në një mbledhje. Do të doja të shkoja, por nuk e di se ku. Jam kurioze të di çfarë mund të diskutojnë në këto mbledhje dhe si mund të na ndihmojnë. Jam gjithë ditën në shtëpi dhe nuk më "ka kërcit" asnjëherë dera", përfundon ajo.

Por ka edhe gra të cilat e dinë çfarë janë dëgjuesat dhe kanë marrë pjesë disa herë, por zhgënjimi është sërish i pranishëm. Ela, 28 vjeçe, thotë se ka marrë pjesë dy herë dhe mendon se asnjë reflektim në realitet, nga ana e pushtetit vendor, nuk ka ndodhur. "Atëherë pse duhem unë aty?" - pyet ajo.

Kjo situatë aktuale për të cilën gratë flasin, është një situatë që na njeh me nuancat jo fort optimiste të marrëdhënies qytetar-qeveri lokale. Një situatë që ka hapësirë për debat dhe përmirësim në favor të këtij target-grupi.

DEMOKRATIZIMI I DEMOKRACISË LOKALE

Hipoteza e ngritur që në fillim të këtij punimi se gratë dhe vajzat janë një zë i munguar në dëgjuesat publike apo në debatin publik lokal konfirmohet nga vetë ato.

Në takimet ballë për ballë me gratë dhe vajzat, shqetësimi kryesor i tyre ishte se ato nuk konsiderohen duke filluar nga familja e deri tek politika. Në intervistat e realizuara mbi matjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në dëgjuesat/konsultat publike rezultojnë probleme serioze me besimin ndaj institucionit të bashkisë dhe të njësive administrative. Humbja e besimit shihet si një prej arsyeve kryesore të mospjesëmarrjes në dëgjuesat.

- Në përgjithësi, ka pak ose aspak gra dhe vajza që marrin pjesë në këtë proces. Ekzaktësisht 93.2% e të intervistuarave nuk kanë marrë asnjëherë pjesë, ndërkohë vetëm 6.8% pohojnë pozitivisht. Edhe në rastet kur ato kanë qënë të pranishme në këto dëgjuesat, sërish nuk e kanë kuptuar qartë rolin e tyre.
- Informacioni që kanë për organizimet e dëgjuesave është shumë i ulët. 70.5% e të intervistuarave nuk kanë dëgjuar dhe nuk kanë informacion se çfarë ndodh aty, ndërkohë që vetëm 19.5% kanë informacion. Kryesisht burimi i këtij informacioni është media dhe jo bashkia apo rrugët e tjera institucionale.
- Interesi që kanë për të marrë pjesë në këto dëgjuesat dhe për t'u dëgjuar është po ashtu i ulët. 62% nuk kanë më interes në raport me 38% të cilët shprehen se do të donin por nuk e dimë kur ndodhin ato.
- Një prej shqetësimeve të tyre është edhe drejtuesi i këtyre dëgjuesave. Ato shprehen se do të preferonin të merrnin pjesë në dëgjuesat publike të cilat drejtohen nga gratë në masën 88.6%, ndërkohë që 8.4% e tyre nuk do e kishin problem drejtimin edhe nga një burrë.
- Gratë dhe vajzat humbjen e besimit të tyre tek institucionet lokale e bazojnë tek fakti se mendimet dhe shqetësimet e tyre

nuk merren parasysh nga drejtuesit e këtij procesi. 70% mendojnë se nuk merren në konsideratë mendimet e tyre dhe se ato duhet thjesht të jenë aty, 13.6% mendojnë pozitivisht dhe 9.3% nuk e dinë.

- Ndërkohë arsye kryesore e mospjesëmarrjes së tyre në këto dëgjesa është mosbesimi me 92%, ndërkohë që 8% nuk kanë pranuar ti përgjigjen kësaj pyetje.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Është e qartë që ndërhyrjet duhet të jenë në dizejnim sa më të qartë të politikave pjesëmarrëse dhe aktive të këtij grupi. Nivelet e zbatimit duhet të japin siguri për angazhim aktiv të tyre.

Për të adresuar në të dy drejtimet, poshtë-lart dhe lart-poshtë ndryshimet që mund të ndodhin në përfshirjen e grave deri në procese vendimmarrëse të sipërpërmendura, një kombinim i politikave informuese në terren me krijimin e forumeve të vogla funksionale brenda njësisë administrative bashkiake është i nevojshëm. Në këtë dokument, mendoj së është shumë e rëndësishme të mos humbim drejtimin e nisur për impaktin e fortë që ka pjesëmarrja e grave dhe vajzave në gjitha dëgjesat publike duke kthyer besimin tek ato se dëgjohen, por edhe duke ofruar mbështetje për fëmijët e tyre, edukimin dhe fuqizimin e tyre si zë i rëndësishëm në hartimin e politikave lokale.

Duket sikur mekanizmi i pjesëmarrjes, në praktikë, ka dështuar. Duke munguar një zë i rëndësishëm në këtë proces, ai i gruas. Megjithatë, çështja e përfaqësimit të tyre në këtë proces është vetëm një element i komponentit të gjerë i pjesëmarrjes së gruas në procese politiko-hartuese në qeverisjen vendore. Kjo hapësirë publike, e cila u takon edhe grave, ka nevojë për transformim, duke bërë të mundur prezantimin e rregullave të reja, ndryshimin e mendësisë që kryepleqtë marrin vendimet për të gjithë komunitetin si dhe teknika të reja përfshirëse.

Këto të dhëna tregojnë se nëse qeverisja lokale dhe shoqëria në përgjithësi dështon të krijojë një ambient ku gratë dhe vajzat lejohen të jenë pjesë e “lojës” dhe të luajnë një rol vërtetë aktiv e domethënës në hartime politikash dhe vendimarrje publike, atëherë ato vendime që merren nuk do kenë pothuajse asnjë efekt si politika publike. Kjo do të thotë që politika nuk po merr në konsideratë pikërisht gjysmën e popullsisë së saj, duke nënkuptuar që vendimet nuk janë ‘fushë’ apo ekspertizë e gruas.

Prandaj, duhet theksuar se ka arsye të mira për të besuar në një zhvillim të mëtejshëm demokratik të përfshirjes së grave dhe vajzave në proceset pjesëmarrëse dhe publike edhe nëpërmjet edukimit joformal. Kjo do të thotë si më poshtë:

Bashkia Shkodër së bashku me njësitë administrative të qarkut të mundësojnë:

1. Ndërhyrje në nivele informuese rreth rëndësisë së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në proceset konsultative për hartimin e politikave lokale.
2. Krijimi i mundësive për ngritjen e ‘Jurive’ të qytetarëve në përbërje ekuilibruese gjinore, të cilët sigurojnë të dhëna dhe informacione për procesin e hartimit të politikave lokale. Kjo juri mund të njohë në kompozimin e saj afërsisht rreth 25 qytetarë të përzgjedhur në mënyrë rastësore dhe që angazhohen të takohen periodikisht. Këto juri shërbejnë për të integruar në procese diskutimesh të gjera dhe shkëmbim informacionesh dhe opinionesh. Kjo është një praktikë e vjetër në Gjermani, qysh në vitin 1970 dhe njihet si model i sukseshëm.
3. Panelet e qytetarëve janë një tjetër rekomandim. Ata lejojnë rritjen e besimit dhe vendosjen e një komunikimi më të mirë midis komunitetit dhe pushtetit lokal.

4. Krijimin e forumit të gruas në çdo njësi administrative. Këto forume angazhohen posaçërisht vetëm në çështjet dhe përditshmërinë e grave dhe vajzave, problemet që ato kane dhe mënyrat si mund të zgjidhen. Këto forume mund të menaxhohen nga nënpunësi i barazisë gjinore, i cili kryen funksionin e

tij pranë sektorit të shërbimit social në bashki.

5. Marrja në konsideratë nga ana e Bashkisë Shkodër të sigurimit të balancës gjinore në drejtimin e dëgjësive publike.

BURIMET

Arendt, Hannah. (1958); *The Human Condition*, Chicago: University of Chicago Press.

Baseline Report; Women Empowerment Indicators. Gender Alliance for Development Center (2013): http://www.gadc.org.al/v2/index.php?option=com_fabrik&c=form&view=details&Itemid=0&fabrik=8&tableid=8&rowid=34&lang=en

Fraser, Nansy. (1990); *Rethinking the public Sphere: A contribution to the Critique of Actually Existing Democracy*.

Habermas, Jurgen. (1992); 'Further Reflections on the Public Sphere.' In *Habermas and the Public Sphere*, ed. Craig Calhoun. Cambridge: MIT Press.

Hess, M., & Adams, D. (2007); *Innovation in Public Management. The role and function of community knowledge*. In vol 12(1), 2007.

Osborne, D., & Gaebler, T. (1992); *Reinventing government*. Reading, MA: Addison-Wesley

Strategjia kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i veprimit 2016-2020: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/201-2016.pdf

Trust in Governance; IDM (2016): http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2015/12/study_citizen_participation.pdf

Wiseman, J. (2006); 'Local Heroes? Learning from Recent Community Strengthening Initiatives in Victoria', *Australian Journal of Public Administration*, Vol. 65 (2), pp.95-107.

Yanow, Dvora. (2003); *Accessing local knowledge*. In *Deliberative policy analysis: Understanding governance in the network society*, ed. M. Hajer and H. Wagenaar, 228-46. Cambridge, UK: Cambridge University Press.